



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 212/5 prot.

Tiranë, më 24.5.2024

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 743, datë 19.3.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Gentian Hamiti
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dajeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 10.5.2024, është njoftuar vendimi nr. 743, datë 19.3.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Gentian Hamiti, aktualisht me funksion gjyqtar, në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 743, datë 19.3.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Gentian Hamiti, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit z. Gentian Hamiti, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*në vijim referuar si Komisioni*), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), Raportin e vlerësimit të figurës nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (*në vijim referuar si AKSIK*) dhe Raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (*në vijim referuar si KLGJ*), nga të cilat rezulton se:

2.1 *ILDKPKI*, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Gentian Hamiti*”,² ka referuar se:

- i. *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;*
- iii. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv. *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- v. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 *DSIK*, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të Raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Gentian *** Hamiti, me nr. *** prot., datë **.10.2017³, ka referuar: “*Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Gentian *** Hamiti*”.

2.3 *KLJGJ*, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, si dhe 5 dokumentet e përzgjedhura në mënyrë rastësore, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit⁴.

2.4 *Gjetje të ONM-së*. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “b” e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se vëzhguesi ndërkombëtar i ka përcjellë Komisionit dy gjetje: (1) *Gjetjen* me nr. *** prot., datë **.5.2023, si dhe (2) *Gjetjen* me nr. **, datë **.1.2024, me qëllim analizimin e disa rrethanave të dala gjatë hetimit administrativ, lidhur me vlerësimin e pasurisë, figurës dhe profesionalit.

3. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Komisioni, në përfundim në lidhje me kriterin e pasurisë, [...] *Në përfundim të vlerësimit të pasurisë, në raport me barrën e provës, shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, trupi gjyqësor arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë*

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, Dh dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Shkresa e ILDKPKI-së me nr. ***/** prot., datë **.7.2018.

³ Deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë **.11.2023.

⁴ Raporti i KLGJ-së me nr. ***/** prot., datë **.11.2021.

deklarime të vërteta e të sakta në Deklaratën Vetting. Nga trupi gjykues nuk u evidentuan problematika lidhur me pasuri në pronësi ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht apo për deklarim të pamjaftueshëm, të cilat mund ta penalizonin atë në kuptim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Nga vlerësimi i provave dhe shpjegimeve në raport me Deklaratën Vetting, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Gentian Hamiti ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë [...].

3.2 Për kontrollin e figurës. Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...] **Në përfundim...**, subjekti ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, të jetë i përfshirë apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të nenit DH të aneksit të Kushtetutës e neneve 34-39 të kreut V të ***, ***, është një lidhje familjare/gjaku e afërt me subjektin e rivlerësimit, të cilin ai nuk ka zgjedhur të ketë kontakt e, për më tepër, nuk rezultoi të ketë marrëdhënie miqësore të vijueshme, por përkundrazi (edhe ato për shkak të marrëdhënies së posaçme janë të vitit 2009 [...]).⁵

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Komisioni, lidhur me këtë kriter, ka arritur në përfundimin se: [...] **Në konkluzion përfundimtar**, lidhur me kriterin e aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se për subjektin e rivlerësimit Gentian Hamiti nuk janë konstatuar mangësi profesionale dhe, në këto kushte, referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, arrin në konkluzionin se subjekti arrin nivelin kualifikues të kërkuar sipas neneve 44/a dhe 59/c të ligjit nr. 84/2016 [...].⁶

3.4 Vlerësimi tërësor. [...] **Në përfundim të vlerësimit të të tre komponentëve të rivlerësimit**, trupi gjykues çmon të vlerësojë sjelljet e subjektit të rivlerësimit lidhur me pasurinë truall me sip. 300 m², blerë në vitin 2002, dhe shitur me akt përfundimtar shitjeje në shkurt të vitit 2008, e marrëdhënien e tij me shtetasin ***, ***. (djali i xhaxhait), veprime të trajtuara më lart në këtë vendim në mënyrë kronologjike e të hollësishme, duke i çmuar ato në raport me parashikimet ligjore të ligjit nr. 84/2016, për sjellje që cenojnë besimin e publikut të drejtësisë. **Në përfundim**, trupi gjykues çmon se tërësia e sjelljeve të subjektit të rivlerësimit të rezultuar nga hetimi administrativ, të vlerësuara në raport të drejtë e proporcional me kërkesat dhe qëllimin e ligjit për rivlerësimin kalimtar, nuk përbëjnë shkak për aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” [...].

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në nenin 58, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 59, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndër të tjera, ka vendosur:

- **Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Hamiti, gjyqtar, aktualisht ushtron funksionin e tij si i komanduar pranë Gjykatës Administrative të Apelit.**

⁵ Për më tepër referohuni në f. 23, 24, prg. 51, 52, 53, të vendimit të Komisionit.

⁶ Për më tepër referohuni në f. 35, prg. 62, të vendimit të Komisionit.

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

6. Në krahasim me kompetencat e njohura Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

7. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

8. *Komisioneri Publik*, nga shqyrtimi i vendimit nr. 743, datë 19.3.2024, çmon se ai është i cenusshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

9. Për sa më sipër, Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 743/2024, të Komisionit, në tërësinë e tij.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

10. Përpara se të vijohet me trajtimin e çështjeve objekt ankimi dhe për të cilat Kolegjit do t’i kërkohet t’i shqyrtojë në zbatim të juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të njohur nga Kushtetuta, paraprakisht Komisioneri Publik çmon të sjellë në vëmendje *Gjetjet* që vëzhguesi ndërkomëtar ka paraqitur në Komision, gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit, z. Hamiti, bazuar në nenin B, pika 3, germa “b”, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenin 49, pika 10, të ligjit nr. 84/2016, të cilat përbëjnë provë në këtë proces, konkretisht:

11. *(1) Gjetja me nr. *** prot., datë **.5.2023, në të cilën, ndër të tjera⁷, referohet se:*

- Nga aktet e administruara në dosjen e subjektit të rivlerësimit, u konstatua se në vitin 2008, subjekti i rivlerësimit i ka shitur⁸ vëllait të tij dhe djalit të xhaxhait të tij, z. *** ***, truallin me sipërfaqe 300 m², me vendndodhje në Delvinë. Nga dokumentacioni i dosjes është konstatuar një lidhje familjare⁹ ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe z. *** ***, Z. ***

⁷ Referohuni më gjerësisht gjetjes në dosje të Komisionit.

⁸ Kontratë shitje, me nr. **/**, datë **.2.2008, para noterit publik ***. ***.

⁹ Kushërinj të parë.

*** është shpallur fajtor më ** tetor 1996 nga Gjykata e Rrethit të Janinës (në Greqi) për veprat: a) mbajtje e narkotikëve; b) transportimi i narkotikëve; c) importim i narkotikëve; d) shitje e narkotikëve e mbetur në tentativë; e) kalim i paligjshëm i kufijve; dhe është dënuar me 18 vjet burgim dhe gjobë në masën 5 milionë dhrahmi.

- Duke pranuar se ky subjekt rivlerësimi ka lidhje familjare me z. *** ***, si dhe disa lidhje interesi - pas dënimit me vendim të formës së prerë të këtij të fundit - siç përcaktohet nga deklarata e subjektit të rivlerësimit në DPV-në e vitit 2004 dhe transaksioni i pasurisë në vitin 2008, sipas mendimit të ONM-së, me qëllim të evidentimit të rrethanave faktike të çështjes, është e nevojshme të sqarohet më tej marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me z. *** *** dhe të verifikohet nëse ka pasur ndonjë kontakt tjetër mes tyre, duke kërkuar informacionin e mëposhtëm:

- Listën e plotë të telefonatave (përfshirë mesazhet tekst) nga shoqëritë e telefonisë celulare “*** ***” sh.a. dhe “*** ***” sh.a., për dy vitet e fundit, të kryera ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, z. *** ***,

- Të dhënat për statusin e regjistrimit të objektit (ndërtesë), të ngritur në truallin me sipërfaqe 300 m², Zona Kadastrale ***, me vendndodhje në Delvinë dhe kopjen e dosjes së regjistrimit, si dhe çdo dokument tjetër përkatës që Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) në Sarandë mund të administrojë për të dyja këto pasuri.

Bazuar në sa më sipër, vëzhguesi ndërkombëtar paraqet dosjet penale, në kuadër të procesit të rivlerësimit të subjektit Gentian Hamiti, për të vlerësuar:

a) Plotësinë e deklaratës së kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit, si dhe ekzistencën e kontakteve të subjektit të rivlerësimit me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

b) Ndikimin e kësaj situate në vlerësimin e përgjithshëm të procesit që mund të konsiderohet si cenim i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

12. Gjetja nr. ** prot., datë **.1.2024, në të cilën, ndër të tjera¹⁰, referohet se:

- Për nevojën që Komisioni të marrë në konsideratë disa rrethana materiale ose mungesën e tyre dhe domosdoshmërinë e respektimit të standardeve minimale procedurale në hetim gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit në fjalë, si më poshtë:

- Mbi hetimin e përgjithshëm të kryer nga Komisioni, vëzhguesi ndërkombëtar konstaton se faktet në lidhje me subjektin e rivlerësimit Gentian Hamiti nuk janë hetuar plotësisht, duke konstatuar se informacioni i siguruar nga një dosje tjetër (dosja që lidhet me bashkëshorten e tij, subjektin e rivlerësimit *** ***) nuk zëvendëson detyrën e trupit gjykues për të hetuar plotësisht të gjitha faktet e çështjes dhe për t'i siguruar subjektit të rivlerësimit mundësinë për të kontribuar në hetim... *E thënë thjesht, edhe nëse proceduralisht Komisioni do të kishte përfshirë provat e çështjes së *** *** në hetimin e Gentian Hamitit, Komisioni nuk mund t'i referohej përfundimeve për çështjen e *** ***, edhe për shkak se ato nuk janë të vërtetuara me vendim të formës së prerë.*

¹⁰ Referohuni më gjerësisht gjetjes në dosje të Komisionit.

Mbi vlerësimin e pasurisë:

- Në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit, pranë bankës *** (ish-***), ka rezultuar një depozitim *cash* nga *** ***, më **10.2009, në shumën 2500 euro, pa përshkrim. Shuma është tërhequr në të njëjtën datë nga subjekti i rivlerësimit. Ky transaksion nuk është deklaruar as në Deklaratat Periodike përkatëse dhe as në Deklaratën *Vetting*. Subjektit të rivlerësimit nuk i është kërkuar të sqarojë arsyet e një depozitimi të tillë, natyrën e tij (hua, dhurim, të tjera) dhe për mosdeklarimin e të ardhurave nga ana e tij, prandaj Komisioni duhet të kërkojë nga subjekti i rivlerësimit të japë informacion në lidhje me këtë transaksion dhe marrëdhëniet me *** ***. Vëzhguesi ndërkombëtar konstaton se sqarimi i mësipërm është i nevojshëm, pasi mungesa e informacionit të mësipërm, si në Deklaratën *Vetting*, ashtu edhe në deklaratat periodike ndër vite, mund të tregojë një deklaram të pasaktë dhe mosdeklarim të plotë të pasurisë.

Mbi vlerësimin e figurës:

- Në maj të vitit 2023, ONM-ja ka paraqitur një *Gjetje* (nr. prot. ***/**5.2023), ku janë referuar informacione lidhur me *** ***, i cili në të kaluarën ka qenë i dënuar për vepra penale të kualifikuara si krim i organizuar. Si rezultat i hetimeve, rezultoi se nga korriku deri në shtator 2021, ka pasur 29 telefonata midis Gentian Hamitit dhe një numri telefonik të regjistruar në një moment të caktuar në emrin e shoqërisë *** sh.p.k., ku *** *** rezulton një prej aksionarëve (*Shoqëria *** sh.p.k., e regjistruar me vendim gjykate, datë **7.2004, me NUIS *** dhe aksionarët e saj janë përkatësisht: *** ***, *** *** dhe *** ****). Komisioni duhet të vlerësojë këtë komunikim (dhe potencialisht të hetojë nëse ka pasur/ka kontakte shtesë me *** ***), pasi mund të cenojë besimin e publikut dhe, në skenarin më të keq, mund të çojë në një përfundim negativ në vlerësimin e figurës. Pavarësisht nga konteksti i krijimit të kësaj lidhjeje (rrethi familjar, miqësi e gjatë etj.), kjo marrëdhënie ka potencialin të diskreditojë një gjyqtar për sa i përket besimit të publikut dhe duhet të vlerësohet.

Mbi vlerësimin e kriterit profesional, për t'i kërkuar shpjegime subjektit dhe për të kërkuar informacion shtesë, ndër të tjera¹¹, lidhur me:

- Vëzhguesi ndërkombëtar njofton Komisionin se nga burime të hapura është konstatuar se, në vitin 2019, subjekti i rivlerësimit Gentian Hamiti është bërë pjesë e debatit publik për marrjen vendimit për heqjen e pezullimit të aktivitetit të vendosur nga organet tatimore për “Kompleksin ***”, pasi, gjatë kontrollit administrativ të kryer në kuadër të aksionit kundër informalitetit, nga organi tatimor u konstatua se nuk lëshonte kupon tatimor.

A. Kontrolli i pasurisë

13. Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramëve të subjektit (“*Vetting*” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij

¹¹ Referohuni më gjerësisht gjetjes në dosje të Komisionit.

dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

14. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave vjetore periodike dhe atë Vetting, dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në datën 23.1.2017, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, rezulton se:

15. Të ardhura të deklaruara në shumën 800.000 lekë nga shitja e truallit me sip.300 m,² në Delvinë

15.1 Në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Të ardhura të përfituara nga shitja e truallit prej 300 m,² sipas kontratës së shitjes nr. ** rep., dhe nr. ** kol., datë **.2.2008. Vlera 800.000 lekë. Pjesa takuese 100%.

15.2 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës së vitit 2005 (si OPGJ), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Në emrin tim ekziston një sipërfaqe trualli prej 300 m², mbi të cilën është ndërtuar një godinë 5-katëshe, por në të vërtetë është e vëllait tim dhe djalit të xhaxhait, të cilët do ta hedhin në emrin e tyre në momentin e hipotekimit të objektit. Ky truall është blerë nga Zyra e Përmbarrimit Sarandë, ku ekziston edhe kontrata e shitjes”*. Vlera 215.000 lekë. Pjesa takuese 0%, krijuar në dhjetor 2002.

15.3 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës si gjyqtar, në vitin 2007 (data e emërimit **.10.2007), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Gjendje cash e përfituar prej shitjes së një trualli me kontratë shitblerjeje, si dhe nga aktiviteti i biznesit të vogël Fast food, i ushtruar së bashku me pjesëtarë të familjes (vëllai)”*. Vlera 1.300.000 lekë¹².

15.4 Lidhur me të ardhurat në shumën 800.000 lekë, të deklaruara si të përfituara nga shitja e truallit me sip. 300 m,² të ndodhur në Delvinë, ndër të tjera, janë administruar aktet sa vijon¹³:

15.5 Kontratë shitjeje nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë **.12.2002, me palë shitëse Zyra e Përmbarrimit Sarandë dhe palë blerëse Gentian Hamiti. Objekt i kontratës është pasuria truall me sip. 300 m², ndodhur në Delvinë, që shitet në vlerën 215.000 lekë.

15.6 Kontratë sipërmarrje (për ndërtim objekti) nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë **.5.2004, me palë pronare të truallit Gentian Hamiti dhe palës sipërmarrëse *** *** dhe *** *. Palët kanë rënë dakord që z. Gentian Hamiti, në cilësinë e pronarit të truallit, duke vënë truallin e mësipërm në dispozicion dhe duke i kaluar sipërmarrësit të drejtën e pronësisë së truallit, do të përfitojë vetëm çmimin e truallit, i përcaktuar nga palët në shumën 800.000 lekë. Shumën e mësipërme, sipërmarrësi ia ka dorëzuar pronarit të truallit jashtë zyrës noteriale, fakt i konfirmuar nga palët.

15.7 Kontratë shitje nr. ** rep. dhe nr. ** kol., datë **.2.2008, me palë shitëse z. Gentian Hamiti dhe palë blerëse *** *** dhe *** *. Objekt i kontratës është pasuria truall me sip.

¹² Në D-Vett., subjekti ka deklaruar, përveç shumës 800.000 lekë nga shitja e truallit dhe të ardhura të përfituara nga ushtrimi i aktivitetit tregtar “Fast Food” me pjesëtar të familjes (vëllai), përpara vitit 2005, shumë e cila është konsumuar ndër vite. Vlera 500.000 lekë. Pjesa takuese 100%.

¹³ Referohuni akteve bashkëlidhur shkresës së Bashkisë Delvinë, nr. ***/* prot., datë **.6.2023, dhe shkresës së ASHK-së Sarandë nr. ***/* prot., datë **.6.2023.

300 m², ndodhur në Delvinë. Palët kanë rënë dakord për shitjen e kësaj pasurie në vlerën 800.000 lekë, e likuiduar nga ana e blerësve jashtë zyrës noteriale.

15.8 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, ndër të tjera¹⁴, ka konstatuar se, në gjendjen që janë aktet dhe për sa subjekti deklaroi gjatë hetimit, duket se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë.

15.9 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet përfundimtare, ndër të tjera, ka deklaruar: [...] Shpjegoj se e ardhura prej 800.000 lekësh, e cila përbën çmimin e shitjes sipas Kontratës së Shitjes nr. ** rep., nr. ** kol., datë **.2.2008, është krijuar/përfutur në datën **.2.2008 dhe jo në datën **.5.2004, në të cilin është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. *** repertori dhe nr. *** koleksioni, datë **.5.2004. Siç konstatohet, kjo kontratë shitje mban datën **.2.2008, ndërsa formulari i deklaratës së interesave përpara fillimit të detyrës është dorëzuar në muajin mars të vitit 2008 [...].

15.10 Komisioni në përfundim, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] konstatimet pjesë e rezultateve të hetimit, përputhen me deklaratimet e vetë subjektit në deklaratat periodike dhe atë Vetting... Subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2007 (dorëzuar në mars 2008) marrëdhënien kontraktore dhe shumën e përfutur duke zbatuar detyrimin për deklarim të kësaj shume nëpërmjet deklaratimit të tij sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003. ... Trupi gjykues çmon se mosdeklarimi prej tij në DPV-në 2007 – 2008 do të sillnin pasaktësi në deklaratimin periodik vjetor e do të bënin gjithashtu më të vështirë verifikimin mbi vërtetësinë e fakteve, duke e lënë këtë marrëdhënie të papërfunduar (në këndvështrim të deklaratimeve ndër vite)[...].

15.11 Komisioneri Publik, lidhur me përfitimin e shumës 800.000 lekë, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, me burim nga shitja e truallit me sip. 300 m² ndodhur në Delvinë, vëren se:

15.12 Në kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë **.5.2004, nënshkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit, lidhur me pagesën e shumës 800.000 lekë, parashikohet se: [...] sipërmarrësi ia ka dorëzuar pronarit të truallit, jashtë kësaj zyre noteriale dhe këtë fakt ma konfirmojnë dhe palët... përmbajtja e kësaj kontrate iu lexua qartë palëve, të cilët si e gjejnë aktin e mësipërm konform vullnetit të lirë të shprehur, e nënshkruajnë në prezencën time [...]. Përmbajtja e kësaj kontrate, bazuar dhe në jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Kolegjit, konsiderohet si referim i vetëm ligjor, për sa kohë që nuk ekzistojnë prova me shpresë me vlerë provuese të plotë apo të dhëna të rëndësishme që burojnë nga burime të pavarura dhe jashtë këtij procesi, që të sugjerojnë për të kundërtën.

15.13 Sa më sipër, rezulton se e ardhura nga shitja e truallit në shumën 800.000 lekë, e përfutur nga kontrata e sipërmarrjes, datë **.5.2004, nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e parë të pasurisë si Oficer i Policisë Gjyqësore, dorëzuar pranë ILDKPKI-së në datën **.6.2005.

15.14 Shuma e mësipërme është deklaruar prej subjektit të rivlerësimit për herë të parë në deklaratën para fillimit të detyrës si gjyqtar (data e emërimit në detyrë **.10.2007). Referuar

¹⁴ Referohuni më gjerësisht konstatimeve të Komisionit në rezultatet e hetimit.

parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, rezulton se deklarata e interesave privatë para fillimit të detyrës duhet të plotësohet dhe të dorëzohet, jo më vonë se 30 ditë nga data e fillimit të detyrës, që në rastin objekt shqyrtimi, është jo më vonë se data **.11.2007.

15.15 Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit e ka disponuar këtë shumë deri në datën **.11.2007, çka bie ndesh me sa deklaroi subjekti se kjo shumë është përfituar në datën **.2.2008.

15.16 Në përfundim, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse, si dhe ka kryer deklarin të pasaktë dhe kontradiktor lidhur me përfitimin e shumës 800.000 lekë, nga shitja e truallit me sip. 300 m², rrethana të cilat duhen marrë në konsideratë në vlerësim tërësor të procedurave, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në vijim dhe të problematikave të tjera të konstatuara, për pasurinë truall 300 m².

16. Lidhur me fitimin e pronësisë së pasurisë truall me sipërfaqe 300 m², Delvinë

16.1 Për këtë pasuri, gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar sa vijon:

16.1.1 Zyra Përbarimore, Sarandë, në mbështetje të nenit 568 të K. Pr. Civile, ka shpallur ankandin për shitje truall 300 m², ndodhur në qytetin e Delvinës, nga i cili ka rezultuar fitues subjekti i rivlerësimit Gentian Hamiti.

16.1.2 Pas shpalljes fitues nga ankandi, midis Zyrës Përbarimore Sarandë, në cilësinë e shitësit, dhe z. Gentian Hamiti, në cilësinë e blerësit, është lidhur kontrata e shitjes nr. *** rep./*** kol., datë **.12.2002, për truallin me sipërfaqe 300 m², me çmimin e shitjes në shumën 215 000 (dyqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë. Më datë **.12.2002, kjo kontratë shitje është regjistruar në ZVRPP, Sarandë, për të cilën është lëshuar dhe vërtetimi nga dokument hipotekor, në datën **.3.2004.

16.1.3 Për këtë pasuri është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. *** repertori dhe nr. *** koleksioni, datë **.5.2004, nënshkruar midis shtetasve Gentian Hamiti, në cilësinë e pronarit të truallit me sipërfaqe prej 300 m² dhe shtetasve ***. e ***. ***. (djali i xhaxhait dhe vëllai i subjektit të rivlerësimit), në cilësinë e palës sipërmarrëse. Në kontratë parashikohet se pala pronare kundrejt përfitimit në vlerë të çmimit të truallit, vë në dispozicion të palës sipërmarrëse, duke i kaluar dhe të drejtën e pronësisë mbi truallin e mësipërm me sipërfaqe 300 m², ku pala sipërmarrëse merr përsipër ndërtimin e një objekti, lokal+banesë, sipas lejes së ndërtimit të miratuar nga organet kompetente.

16.1.4 Nëpërmjet vendimit nr. **, datë **.3.2004 të KRT-së Bashkia Delvinë dhe lejes së ndërtimit nr. **, datë **.4.2004, është ndërtuar objekti lokal + banesë (1+5), mbi sipërfaqen 300 m², me investitorë z. *** *** dhe z. *** ***. Në vijim është miratuar leja e shfrytëzimit të objektit, datë **.8.2005 dhe akt-kolaudit, datë **.8.2005, në emër të investitorëve, z. *** *** dhe z. *** ***. Bazuar në këto dy akte, është bërë regjistrimi i këtij objekti pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, në emër të z. *** *** dhe z. *** ***.

16.1.5 Subjekti ka referuar se në mbështetje të detyrimeve, të cilat buronin nga kontrata e sipërmarrjes nr. *** rep./***kol., datë **.5.2004, ka lidhur kontratën e shitjes nr. ** rep./** kol., datë **.2.2008. Kjo kontratë shitje ka pasur për palë të saj: shitës Gentian Hamiti dhe blerës, z. *** *** dhe z. *** ***.

16.1.6 Po ashtu, nga aktet e përcjella nga Bashkia Delvinë, rezulton e administruar dhe deklarata noteriale nr. *** rep., datë **.12.2009, e shtetasve Gentian Hamiti, *** *** dhe *** ***, në të cilën deklarojnë se, me marrëveshje me njëri-tjetrin duan të prishin kontratën e sipërmarrjes të datës **.5.2004.

16.1.7 Komisioni ka hetuar edhe lidhur me faktin nëse pasuria e paluajtshme *truall*, me sipërfaqe 300 m², ka qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor. Në periudhën kur subjekti i rivlerësimit ka qenë pronar i pasurisë, janë shqyrtuar dy çështje gjyqësore: (1) Çështja civile me palë: Padiës *** ***, I Paditur: Gentian Hamiti; Person i tretë: Zyra Përmbarrimore Sarandë dhe shtetasi *** *** dhe (2) Çështja civile me palë: Padiësë *** ***, I Paditur: Gentian Hamiti; me Objekt: Pushim cenim pronësie.

16.1.8 (1) **Çështja civile me palë:** Padiës *** ***, i Paditur: Gentian Hamiti; Person i tretë: Zyra Përmbarrimore Sarandë dhe shtetasi *** ***, ka për Objekt: Kundërshtimin e veprimeve përmbarrimore të kryera nga Zyra Përmbarrimore Sarandë lidhur me ekzekutimin e vendimit nr. ***, datë **.6.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë; Anulimin e ankandit të zhvilluar në datën **.12.2002 për shitjen e një sipërfaqe truall prej 300 m², anulimin e vendimit datë **.12.2002, të zyrës përmbarrimore për kalimin e pronësisë në favor të të paditurit, konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.12.2002 dhe fshirjen e saj nga ZRPP Sarandë:

- Me vendim nr. ***, datë **.5.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është vendosur “Rrëzimi i kërkesë padisë, si i pabazuar në ligj e në prova. Kundër këtij vendimi, ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Gjirokastër padiësi *** ***.

- Gjykata e Apelit, me vendimin nr. ***, datë **.11.2004, ka vendosur “Pranimin e padisë. Anulimin e veprimeve përmbarrimore “ankand për shitjen e truallit të datës **.12.2002” të Zyrës së Përmbarrimit Sarandë. **Anulimin e vendimit nr. **, datë **.12.2002, të përmbarruesi për kalim pronësie. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol. datë **.12.2002, fshirjen e saj nga ZRPP Sarandë dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme.** I padituri Gentian Hamiti paraqiti Rekurs në Gjykatën e Lartë, ku, në datën **.12.2005, u vendos mospranimi i rekursit me vendimin nr. *** .

16.1.9 (2) **Çështja civile me palë:** Padiësë *** ***, I Paditur: Gentian Hamiti; me Objekt: Pushim cenim pronësie. Padiësja pretendon se i padituri ka filluar ndërtimin e një objekti pa leje ndërtimi mbi truallin e saj dhe kërkon pushimin e cenimit të pronësisë. Sipas mendimit të ekspertit, midis pasurive ka mbivendosje me 39 m².

- Me vendim nr. ***, datë **.11.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë, është vendosur “Rrëzimi i kërkesëpadisë së padiësës, si i pabazuar në ligj e në prova. Në këtë vendim, ndër të tjera, përshkruhet se: [...] bazuar në provat e paraqitura nga i padituri ... çmon se i padituri në punimet që kryen është në cilësinë e pronarit dhe ndërtimin e ka kryer me leje

ndërtimi nga Bashkia [...]. Kundër këtij vendimi, paditësja *** ** ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

- Gjykata e Apelit, e cila, pasi ka administruar gjatë gjykimit edhe vendimin nr. ***, datë **.11.2004, të po kësaj gjykate, ka vendosur, me vendimin nr. **, datë **.2.2005, “Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë **.11.2004, të Gjykatës së Shkallës së Parë, Sarandë, pranimin e padisë dhe detyrimin e të paditurit të pushojë cenimin e pronësisë, duke prishur ndërtimet e kryera nga i padituri Gentian Hamiti në sip. prej 39m²”.
- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. ***, datë **.6.2006, vënë në lëvizje nga rekursi i subjektit të rivlerësimit, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë **.11.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë, dhe vendimit nr. **, datë **.2.2005, duke arsyetuar, ndër të tjera, se me vendimin gjyqësor të formës së prerë, nr. ***, datë **.11.2004, Gjykata e Apelit Gjirokastrë, është anuluar shitja, është anuluar vendimi i përmbaruesit për kalimin e pronësisë në favor të Gentian Hamiti dhe është urdhëruar fshirja e regjistrimit të pronës në emër të Gentian Hamiti.

16.2 Komisioni, përveç sa më sipër nga shqyrtimi dhe krahasimi i të gjitha dokumenteve të administruara, lidhur me objektin truall + ndërtesë, në qytetin e Delvinës, ka konstatuar ekzistencën e dy lejeve të ndërtimit, të lëshuara për të njëjtën pronë truall, e cila ishte e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, konkretisht:

- *Leje ndërtimi, datë **.4.2004, Subjekti ndërtues “****” sh.p.k., për Lokal dhe banesë vetjake (1+5), financohet nga *** ***, ***, ***, me vendim të KKRT nr. **/*, datë **.04.2004;*
- *Leje ndërtimi, datë *.8.2004, Subjekti ndërtues “****” sh.p.k., për Lokal dhe banesë vetjake (1+5), financohet nga Gentian Hamiti, me vendim të KKRT nr. **/*, datë **.04.2004.*

16.3 Bashkia Delvinë, me shkresën nr. ***/* prot., datë **.2.2024, në përgjigje të kërkesës së vëzhgueses ndërkombëtare të ONM-së, ka vënë në dispozicion dokumentacionin dhe lejen e ndërtimit lidhur me objektin (ndërtesë), të ngritur në truallin në pronësi të shtetasit Gentian Hamiti, me investitor z. *** ** dhe z. *** **, në qytetin e Delvinës, si dhe, ndër të tjera, ka referuar se [...] *Ju sqarojmë se në lidhje me praktikën dokumentare të mbajtur nga zyra urbanistike pranë Bashkisë Delvinë mbi nxjerrjen e lejes së ndërtimit nr. **/*, datë **.04.2004, kjo leje ndërtimi është dhënë për ndërtimin e godinës objekt lokal+banesë (1+5), Bashkia Delvinë, mbi truallin në pronësi të shtetasit Gentian Hamiti, në kohën që është lëshuar leja e ndërtimit. Gabimisht, leja e ndërtimit nr. **/*, datë **.04.2004, ishte dhënë për shoqërinë ndërtuese “****”sh.p.k., duke paraqitur si investitor shtetasin Gentian Hamiti [...].*

16.4 Komisioni ka vënë re se, edhe në këtë përgjigje të Bashkisë së Delvinës, ka mospërputhje:

- *Data e nënshkrimit të lejes së ndërtimit, që pretendohet të jetë lëshuar gabimisht, është nënshkruar më **.08.2004, gati 4 muaj më vonë se ajo e mëparshme, të cilës Bashkia i referohet në përgjigjen e saj si leje ndërtimi e saktë. Gjithashtu, leja e gabuar e ndërtimit, në të cilën paraqitet subjekti i rivlerësimit si investitor, ka qenë ajo e përdorur nga subjekti i*

rivlerësimit Gentian Hamiti në çështjet gjyqësore të pronësisë së tij (e paraqitur si provë prej tij gjatë procesit gjyqësor);

- Leja e ndërtimit të cilës Bashkia i referohet si e saktë është nënshkruar më **.04.2004, pra para vendimit të KKRT-së nr. **/*, datë **.04.2004;
- Në dokumentet shoqëruese të dërguara tek ne, faqe 13, dokumenti “Përlllogaritjet e kostos”, investitori është subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria e ndërtimit është *** sh.p.k.;
- Gjithashtu, në Aktin e Kolaudimit (kolaudim i punimeve) datë **.08.2005, shoqëri ndërtimi është “****” sh.p.k. dhe investitorë janë shënuar *** dhe **** ***, informacion që bie ndesh me përgjigjen e Bashkisë, e cila i referohet shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k.

16.5 Sa më sipër, Komisioni, ndër të tjera¹⁵, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ka arritur në përfundimin se: (1) ndërtesa 5-katëshe mund të jetë financuar [në vlerën 11.934.706 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e gjashtë) lekë] nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe (2) se ajo mund të jetë një pasuri e fshehur e tij.

16.6 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ndër të tjera, ka shpjeguar se: [...] Nuk ekziston fshehje pasurie nga ana ime ... Në datën **.6.2005 jam emëruar në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ... Pra, objekti lokal + banesë (1+5) kishte përfunduar kur unë isha emëruar oficer i policisë gjyqësore ... si një qytetar i ndershëm i këtij vendi e kam pasur të pamundur financiarisht për të përballuar dhe investuar shumën 11.934.706 lekë, që përfaqëson koston e ndërtimit objekt lokal + banesë (1+5). Leja e Ndërtimit nr. **/*, datë **.4.2004, ku del financiar/me investitor Gentian Hamiti, me shoqëri ndërtimi “****” sh.p.k., është lëshuar me gabime nga Bashkia Delvinë, kjo provohet nga përmbajtja e shkresës nr. **/*/ prot., datë **.2.2024, të Bashkisë Delvinë, (administruar prej jush), në të cilën pasqyrohet: Gabimisht Leje e Ndërtimit nr. **/*, datë **.4.2004, ishte dhënë për shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k., duke paraqitur si investitor shtetasin Gentian Hamiti. Për këtë gabim mendoj se nuk mund të ngarkohem me përgjegjësi ... Leja e Ndërtimit nr. **/*, datë **.4.2004, ku del financiar/me investitor Gentian Hamiti, me shoqëri ndërtimi “****” sh.p.k., është dhënë me gabime nga Bashkia Delvinë dhe është përdorur vetëm në proces gjyqësor, në një situatë të paqëllimshme ... Për zbatimin e Lejes së Ndërtimit nr. **/*, datë **.4.2004, ku del financiar/me investitor Gentian Hamiti, me shoqëri ndërtimi “****” sh.p.k., nuk ka kontraktim nga ana ime të një kolaudatori sipas nenit 12, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 [...].

16.7 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, lidhur me faktin e mosfshirjes së emrit të tij në regjistrin hipotekor pas vendimit gjyqësor me z. *** (vendimi i gjykatës së Apelit Gjyrokastres nr. ***, datë **.11.2004, mbi konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitblerjes nr. *** rep, nr. *** kol., datë **.12.2002, fshirjen e saj nga ZRPP Sarandë dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme), ka paraqitur në cilësinë e provës dy deklarata noteriale:

¹⁵ Komisioni i ka kërkuar subjektit të sqarojë në mënyrë kronologjinë dhe shteruese historikun e krijimit dhe të tjetërsimit të pasurisë, veprimet juridike të ndodhura dhe dokumentacion justifikues lidhur me këtë pasuri.

- (1) Atë të datës **5.2024, bërë prej shtetasit ***. ***. (***. ***), shtetas grek, sipas së cilës deklarohet se në rrethanat që shtetasi ***. ***. më ofroi një dëmshpërblim të kënaqshëm monetar duke përfshirë edhe shpenzimet gjyqësore, humba interesin për këtë truall dhe hoqa dorë përfundimisht prej tij bashkë me ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Apelit;
- (2) Deklarata noteriale nr. ***rep./ *** kol., datë **.2.2024, e z. ***. ***, me profesion avokat dhe përfaqësues ligjor në proceset gjyqësore i z. ***. ***, ku deklaroi se z. ***. ***, nuk e ka vendosur ndonjëherë në ekzekutim vendimin nr. ***, datë **.11.2004, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, pasi në dijeninë e tij ai është shlyer për të rreth vitit 2005.

16.8 Në përfundim, Komisioni ka arsyetuar se: [...] *objekti godinë 5-katëshe është pasuri e vëllait të subjektit dhe kushëririt të tij e se nuk ka asnjë dyshim se ajo është pasuri e investuar nga subjekti i rivlerësimit (tërësisht apo pjesërisht), për shkak të provave të pakontestueshme lidhur me pronësinë, përdorimin dhe posedimin e saj herët në kohë, si dhe rezultoni e provuar se ajo është ndërtuar herët në vitet 2003 – 2005, kur për subjektin e rivlerësimit nuk ka asnjë dyshim të arsyeshëm se mund të jetë përfshirë në veprimtari ku të ketë përfituar të ardhura apo të mira materiale, për shkak të ndonjë funksioni publik prej tij apo ndonjë veprimtarie tjetër. Trupi gjykues çmon të vlerësojë në këtë kuadër edhe tërësinë e sjelljeve të subjektit, të cilat e kanë ndërlidhur atë me këtë pasuri deri në muajin shkurt të vitit 2008, e shpjeguar edhe më lart në këtë vendim, e çmon se tërësia e tyre është pasojë e veprimeve juridiko-civile të kryera nga institucione publike e marrëdhënie juridiko-civile private mes palëve, për të cilat ai ka mbetur i ndërvlarur, për shkak të një situate që e lidhte atë në vitin 2002 me pasurinë truall, pjesë e kësaj marrëdhënieje juridiko-civile [...].*

16.9 Komisioni, lidhur me sinqeritetin e subjektit në këto deklarime apo etika e tij në sjelljet dhe veprimet deri në vitin 2008, e ka trajtuar në një vlerësim proporcional dhe objektiv në vlerësimin tërësor të kësaj çështjeje, duke arsyetuar, ndër të tjera, se: [...] *Pavarësisht se u evidentuan disa rrethana (fakte, ngjarje e të dhëna) që meritojnë të analizohen në kuadër të vlerësimit tërësor sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, i udhëhequr nga parimi i proporcionalitetit dhe objektivitetit, i ndodhur para elementeve të tilla si: (i) një pjesë e konstatimeve i përkasin periudhës kur subjekti nuk ka ushtruar asnjë funksion publik apo edhe pak më vonë kur ai ushtronte detyrën e OPGJ-së; (ii) personat me të cilët ka kryer këto veprime rezultojnë të afërt familjarë me lidhje gjaku; (iii) mbi të gjitha nuk u evidentua që ushtrimi i funksionit të gjyqtarit të ketë ndikuar në ndonjë mënyrë apo rrethanë, apo anasjelltas të ketë ndikuar në ushtrimin e detyrës së tij, situata e rezultuar nuk është e mjaftueshme për të bërë të zbatueshëm aplikimin e nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016, për cenimin e besimit të publikut tek drejtësia [...].*

16.10 Në përfundim, në vlerësim tërësor të procedurave, ndër të tjera, Komisioni ka çmuar se tërësia e sjelljeve të subjektit të rivlerësimit të rezultuara nga hetimi administrativ, të vlerësuara në raport të drejtë e proporcional me kërkesat dhe qëllimin e ligjit për rivlerësimin kalimtar, nuk përbëjnë shkak për aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

16.11 Komisioneri Publik, lidhur me sa më sipër, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime bindëse dhe deklaratimet e tij nuk janë të besueshme në raport me rrethanat e konstatuara.

16.12 Vlerësimi i Komisionit se një pjesë e konstatimeve i përkasin periudhës kur subjekti nuk ka ushtruar asnjë funksion publik, bien ndesh me aktet e administruara, ku konstatohet se, më së paku, dy nga veprimet juridike, lidhur me tjetërsimin e kësaj pasurie, kanë ndodhur gjatë kohës kur subjekti i rivlerësimit ishte në detyrë, konkretisht kontrata e shitjes e vitit 2008, me palë blerëse shtetasit ***. dhe ***. ***, si dhe deklaratat noteriale e vitit 2009, në të cilën subjekti dhe palët e përfshira prishin kontratën e sipërmarrjes të vitit 2004.

16.13 Për më tepër, në kohën e kryerjes së këtyre veprimeve juridike, subjekti i rivlerësimit ishte në dijeni të vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër nr. ***, datë **.11.2004, i formës së prerë, që kishte shpallur absolutisht të pavlefshme kontratën e shitjes me Zyrën e Përmbartimit dhe kishte urdhëruar kthimin në gjendjen e mëparshme. Me fjalë të tjera, veprimet juridike të kryera prej tij, janë sjellje në cilësinë e pronarit, ndërkohë që ishte në dijeni të faktit se me vendim gjyqësor përfundimtar, titulli i pretenduar prej tij i pronësisë nuk ishte më i ligjshëm. Deklaratat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të mosekzekutimit të këtij vendimi, janë kryer gjatë procesit të rivlerësimit, në funksion të deklaratimeve të subjektit dhe bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, merren me rezervë në këtë proces dhe nuk passjellin asnjë ndryshim të rrethanave juridike të parashtruara më lart.

16.14 Përgjigjja e Bashkisë Delvinë, e vitit 2024, e cila referon se leja e ndërtimit në emër të subjektit të rivlerësimit është lëshuar gabim, merret me rezervë në këtë proces, për sa kohë i referohet një gabimi të mundshëm administrativ të kryer në vitin 2004, rreth 20 vite më vonë nga data e lëshimit të saj dhe kur vlefshmëria e aktit nuk rezulton të jetë modifikuar, as në rrugë administrative a gjyqësore.

16.15 Për më tepër, ekzistenca e dy lejeve të ndërtimit për të njëjtin objekt me përmbajtje të ndryshme, si dhe përdorimi i tyre në zyrat administrative dhe në proceset gjyqësore, nga subjekti sipas rastit, nuk duket aq i paqëllimshëm, për sa kohë këtë akt, subjekti e ka paraqitur në mbështetje të pretendimeve të tij si pronar i truallit dhe investitor i objektit.

16.16 Të gjitha këto rrethana, së bashku me gjetjet e tjera të trajtuara në vijim dhe në vlerësimin e kontrollit të figurës, lidhur me gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, mbi dënimet e shtetasit ***. ***, person i përfshirë në këtë investim, duhen të vlerësohen nga Kolegji, në zbatim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, mbi etikën dhe integritetin e magjistratit, dhe referojnë aplikimin e nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

17. Deklarimi i pasurisë së bashkëshortes, * *** (***)**

17.1 Në Deklaratën “Vetting”, personi i lidhur, znj. *** *** (***), ndër të tjera, ka deklaruar pasuritë si vijon: (i) Apartament banimi me sipërfaqe 106 m², me vlerë 50.000 euro, me burim të deklaruar të ardhurat e siguruara nga aktiviteti i familjes bujqësore prej vitit 1994 deri në vitin 2011; (ii) Të ardhura nga aktiviteti privat familjar bujqësor: vreshtari, ullishte, bujqësi, shpendari dhe blegtori, vlera 53.000 euro; (iii) Garazh, me sipërfaqe 23,04 m², në vlerën 500.000 lekë, me të ardhura nga paga e punës dhe aktivitetit privat bujqësor të familjes bujqësore.

17.2 Komisioni, lidhur me pasuritë e sipërcituara të deklaruara nga personi i lidhur, ka konstatuar sa vijon:

(I) Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip.106 m², rezulton se kjo pasuri është përfutur sipas Kontratës së Porosisë datë **.5.2011 dhe Kontratës së Shitjes nr. ** rep., nr. **/* kol., datë **.9.2012. Kjo pasuri konfirmohet në emër të personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, sipas “Certifikatës për vërtetim pronësie”, datë **.9.2012. Shuma 50.000 euro për blerjen e apartamentit është paguar e ndarë në 5 këste, të cilat janë paguar nëpërmjet sistemit bankar¹⁶ dhe *cash*,¹⁷ gjatë periudhës **.5.2011 - **.8.2011.

- Për sa më sipër, Komisioni ka arsyetuar se, në lidhje me regjimin juridik pasuror martesor të kësaj pasurie, në analizim të dokumentacionit të administruar, vëren se bazuar në ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003, “Kodi i Familjes”, i ndryshuar, Kreu II, nenet 73 e vijues, pasuria “apartament” nuk rezulton të jetë një pasuri e fituar gjatë martesës, por e krijuar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit dhe familja e saj, përpara marrëdhënies si “person i lidhur” me subjektin e rivlerësimit. Kjo pasuri është vlerësuar nga trupi gjykues që ka kryer procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin ***. *** (***) , trajtuar me vendimin nr. 605/2022 të Komisionit, si dhe rezulton e krijuar përpara marrëdhënies si person i lidhur me subjektin e rivlerësimit.

17.3 Lidhur me të ardhurat nga aktiviteti privat familjar bujqësor, në vlerën 53.000 euro, nga të cilat 50.000 euro janë depozituar në bankat e nivelit të dytë, Komisioni ka konstatuar se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka depozituar shumën 50.000 euro, përkatësisht në *** Bank (ish-***), *** Bank dhe *** *** Bank¹⁸.

- Komisioni vëren se këto të ardhura janë depozituar në bankë nga znj. *** ***, në periudhën mes viteve 2011 – 2012, duke deklaruar se kanë pasur si burim të ardhurat nga familja bujqësore e familjes së origjinës së znj. ***. ***. Lidhur me shumën e depozituar dhe mundësitë financiare për krijimin e kësaj gjendjeje likuiditetesh është hetuar nga trupi gjykues që ka vlerësuar znj. ***. ***, për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar. Kjo shumë në vetvete është krijuar para lidhjes së martesës me subjektin e rivlerësimit Gentian Hamiti dhe është transferuar në llogarinë e prindërve të znj. ***, në vitin 2015 (duke vlerësuar se është kthyer në vendin e origjinës). Gjithashtu, kjo shumë nuk është përdorur për krijimin e ndonjë pasurie apo interesi tjetër që lidhet me subjektin e rivlerësimit objekt vlerësimi.

- Komisioni në lidhje me regjimin juridik pasuror martesor të kësaj pasurie, në analizim të dokumentacionit të administruar, vëren se, bazuar në ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003, “Kodi

¹⁶ Rezulton se janë kaluar shumat nga llogaria e shtetasës ***. *** në llogarinë e shoqërisë “*****” sh.p.k., përkatësisht: a) paguar nëpërmjet ***-së (sot *** Bank) me transfertë, 4 këste, secila në shumën 10.000 (dhjetë mijë) euro, me përshkrimin: “Pagesë për blerje apartamenti”, në datat: **.5.2011; **.5.2011; **.8.2011 dhe **.8.2011.

¹⁷ Rezulton se është depozituar *cash* shuma 10.000 (dhjetë mijë) euro në llogarinë e shoqërisë me përshkrimin: “Pagesë për blerje apartamenti”, në datën **.8.2011.

¹⁸ (i) Znj. **, në datën **.8.2011, ka depozituar në ** Bank shumën 10.000 euro dhe, në datën **.11.2011, ka depozituar në po këtë bankë shumën 10.000 euro. Në vitin 2015, të dyja depozitat e krijuara me shumat e sipërcituara kanë arritur vlerën 21.726,87 euro dhe është transferuar në llogarinë e saj në *** Bank. (ii) Znj. *** ka depozituar, në datën **.8.2012, në *** Bank, shumën 20.000 euro. Në datën **.7.2015, depozita ka arritur vlerën 21.135 euro dhe është transferuar në llogarinë e saj në ** Bank. (iii) Znj. *** ka depozituar, në datën **.11.2011, në *** Bank, shumën 10.000 euro, e cila ka kaluar në depozitë. (iv) Shuma e krijuar si rezultat i akumulimit të të gjitha depozitave dhe interesave bankare, në vlerën 53.356,84 euro, është transferuar nga znj. ***. *** (***) në llogarinë e nënës së saj, znj. ***. ***.

i Familjes”, i ndryshuar, Kreu II, nenet 73 e vijues, pasuria nuk rezulton të jetë e fituar gjatë martesës. Gjithashtu vlerëson se përputhet deklarimi i personit të lidhur/bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit me deklarimin e bërë prej saj në Deklaratën “Vetting”. Kjo çështje vlerësohet se nuk afekton subjektin e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar, pasi nuk ka ndikuar në krijimin e ndonjë pasurie e se, lidhur me pozicionin e vetë znj. ***, ***, ajo është vlerësuar me vendimin nr. 605/2022 të Komisionit.

17.4 Lidhur me pasurinë Garazh me sip. 23,04 m², rezulton se kjo pasuri është përfituar me Kontratë Shitjeje nr. ** rep., nr. **/** kol., datë **.9.2012, me të ardhura nga puna dhe nga aktiviteti privat, në vlerën 500.000 lekë¹⁹. Kjo pasuri figuron e regjistruar në emër të personit të lidhur, znj. *** **.

- Komisioni, lidhur me deklarimin për burimin e krijimit për pasurinë *garazh*, i është referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin, përfunduar me vendimin nr. 605/2022 të Komisionit, duke arritur në konkluzionin se ka burime financiare të mjaftueshme për krijimin e pasurisë. Në përfundim, Komisioni ka çmuar se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar, duke mos rezultuar problematika.

17.5 Komisioneri Publik, paraprakisht, çmon të sjellë në vëmendje të Kolegjit se vendimi i Komisionit nr. 605, datë 21.12.2022, për konfirmimin në detyrë të znj. Moçka, është ankimuar me ankimin nr. 50/5 prot., datë 3.2.2023, pasi është arritur në përfundimin se: *[...] referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, të administruara për efekt të procesit të rivlerësimit, dhe gjendjes së dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të tij, subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur me të ndodhen në kushtet e pamjaftueshmërisë, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b”, dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 [...].*

17.6 Sa më sipër, Komisioneri Publik gjen të drejtë konstatimin e vëzhguesit ndërkombëtar në Gjetjen nr. ** prot., datë **.1.2024, në të cilën ka konstatuar se: *[...] informacioni i siguruar nga një dosje tjetër nuk zëvendëson detyrën e trupit gjykues për të hetuar plotësisht të gjitha faktet e çështjes dhe për t'i siguruar subjektit të rivlerësimit mundësinë për të kontribuar në hetim. Duke qenë se çështjet e dy bashkëshortëve nuk janë bashkuar, Komisioni nuk mund të përdorë konkluzionet për subjektin e rivlerësimit *** ** me delegim, pra duke iu referuar atyre pa pasur konkluzione të pavarura për çështjen e Gentian Hamitit. E thënë thjesht, edhe nëse proceduralisht Komisioni do të kishte përfshirë provat e çështjes së *** ** në hetimin e Gentian Hamitit, Komisioni nuk mund t'i referohej përfundimeve për çështjen e *** **, edhe për shkak se ato nuk janë të vërtetuara me vendim të formës së prerë [...].*

17.7 Në vijim, Komisioneri Publik, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës, si dhe ligjit nr. 84/2016, vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur/tjerë të lidhur me të, për efekt të këtij procesi, ngarkohen me detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të

¹⁹ Znj. ***, e pyetur gjatë hetimit administrativ të kryer për të për këtë pasuri, ka sqaruar: Në lidhje me vlerën 500.000 lekë të paguar për blerjen e garazhit deklaroj se nga ky çmim janë paguar 3.000 euro nga të ardhurat e aktivitetit privat bujqësor dhe blegtoral. Pjesa tjetër e çmimit, diferenca në shumën 85.730 lekë është paguar me të ardhurat nga paga e funksionit si prokurore.

krijimit të pasurive të deklaruara, detyrim ky dhe i subjektit të rivlerësimit, z. Hamiti, për më tepër, në kushtet kur nga aktet e administruara rezulton se:

(1) Në DV-2012, znj. *** *** ka plotësuar Deklaratën e Interesave Privatë në cilësinë e personit të lidhur, si bashkëjetuese e z. Gentian Hamiti;

(2) Në përgjigje të Pyetësorit nr.1, i pyetur nga Komisioni lidhur me adresat e banimit, subjekti ka deklaruar se, nga janari i vitit 2012 deri në **.11.2013, ka jetuar në apartamentin e blerë nga familja e bashkëshortes, me kontratën e porosisë datë **.5.2011 dhe kontratën përfundimtare të shitjes datë **.9.2012;

(3) Në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, i pyetur nga Komisioni, lidhur me kohën kur ka filluar njohja/lidhja me znj. *** ***, subjekti ka deklaruar se njohja me bashkëshorten ka qenë rreth periudhës fund pranvere – fillim vere të vitit 2011;

17.8 Rezulton se pagesat e kryera për blerjen e pasurive *apartment banimi*, me sip.106 m² (në vlerën 50.000 euro), garazh me sip. 23,04 m² (në vlerën 500.000 lekë), dhe depozitimet *cash* të kursimeve, në shumën totale 50.000 euro, janë kryer në periudhën maj 2011-2012.

17.9 Në përfundim të sa më sipër, Komisioneri Publik, në kushtet kur në ankimin e datës nr. 605, datë 21.12.2022, ka arritur në përfundimin se znj. **, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, nuk arrin nivel të besueshëm në kontrollin e pasurisë dhe ligjshmërinë e burimeve të deklaruara për krijimin e tyre, në kushtet kur një pjesë e pasurive janë krijuar gjatë njohjes apo dhe bashkëjetesës me subjektin e rivlerësimit, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni dhe vlerëson se situata financiare e saj afekton subjektin e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar.

17.10 Komisioneri Publik vlerëson se këto situata duhen çmuar nga Kolegji në zbatim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në vlerësim tërësor të procedurave, në funksion të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

18. Të dhënat e llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit pranë * bank.** Nga aktet e administruara në dosje, Komisioni ka konstatuar se, në datën **.10.2009, është kredituar në llogarinë e subjektit, në *** Bank, shuma 2.500 euro, me përshkrim: “*Cash deposit ****”, shumë e cila është tërhequr nga subjekti i rivlerësimit, në të njëjtën datë.

18.1 Vëzhguesi ndërkombëtar, me gjetjen nr. ** prot., datë **.1.2024, ndër të tjera, ka referuar se ky transaksion nuk është deklaruar as në DV-2009 dhe as në D-Vett., si dhe subjektit të rivlerësimit nuk i është kërkuar të sqarojë arsyet e një depozitimi të tillë, natyrën e tij (hua, dhurim, të tjera) dhe për mosdeklarimin e të ardhurave nga ana e tij, prandaj Komisioni duhet të kërkojë nga subjekti i rivlerësimit të japë informacion në lidhje me këtë transaksion dhe marrëdhëniet me z. *** ***.

18.2 Lidhur me këtë *konstatim*, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime dhe sqarime mbi marrëdhënien me shtetasin *** *** dhe transaksionin bankar të kryer.

18.3 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ka deklaruar se: [...] me z. *** ***, kam përfunduar Shkollën e Magjistraturës. Me këtë shtetas kam pasur një marrëdhënie korrekte, siç ka qenë marrëdhënia ime dhe më të gjithë studentët e tjerë. Në vitin 2009, sipas kërkesës

së tij, i kam huazuar shumën 2.500 euro, shumë e cila ka derivuar nga çmimi i kontratës së shitjes së truallit, nr.*** rep. Dhe nr.** kol., datë **.2.2008, së truallit me sip.300 m². Kjo shumë më është kthyer prej tij rreth muajit tetor 2009, nëpërmjet sistemit bankar [...].

18.4 Komisioni, në vendim shprehet se:²⁰ gjatë seancës dëgjimore u pyet subjekti lidhur me marrëdhënien e tij me shtetasin ***. ***. (gjithashtu, subjekt rivlerësimi) e, konkretisht, lidhur me deklaratimet e bëra prej tij për këtë marrëdhënie²¹ (veprimet bankare të referuara më lart), për të cilat, ai tha se nuk ishte njohur më parë me to e se kishte të njëjtin shpjegim për këtë çështje.

18.5 Në përfundim, Komisioni këtë çështje nuk e konsideroi me probleme në deklaram që mund të shërbejnë si shkelje të tilla që të formojnë bazën e duhur ligjore për aplikimin e ndonjë mase disiplinore e, për më tepër, që ky element nuk prodhon ndonjë pasojë apo efekt të rëndësishëm mbi analizën e Komisionit, për sa i përket zotërimit të pasurisë likuiditet, për të cilën ka mbuluar të gjitha shpenzimet.

18.6 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka përfunduar Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime bindëse dhe deklarimi i tij nuk është i besueshëm. Në drejtim të analizës së fakteve që kanë rezultuar nga hetimi administrativ lidhur me provueshmërinë e marrëdhënies me shtetasin ***. ***, dhe transaksionin bankar të kryer, Komisioneri Publik vlerëson të konsiderojë të dhënat e vendimit nr. 624, datë 20.2.2023, të Komisionit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit ***. ***, vendim ky i formës së prerë, i publikuar në faqen zyrtare të Komisionit²².

18.7 Nga verifikimi i vendimit nr. 624, datë 20.2.2023, në prg. 10.1 të tij dhe në vijim, rezulton se:

18.7.1 [...] Në deklaratën “Vetting”, z. ***. ***, ndër të tjera, ka deklaruar se ka pasur në posedim *Automjetin ***, blerë në tetor të vitit 2009, pa dokumente të rregullta në shumën 2.500 euro.*

18.7.2 *Në DPV-në e vitit 2009, z. ***. ***. deklaroi blerjen e një automjeti ***, blerë në 2009 nga lekët e marra kredi në muajin tetor 2,500 euro, ndërsa në DPV-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar shitjen e këtij automjeti në muajin tetor 2014, në vlerën 100,000 lekë.*

18.7.3 Në përgjigje të pyetësorit standard, z. ***. *** ka deklaruar se ka blerë *automjetin *** në vlerën 2,500 euro, shtetasit G. H., por, për shkak të konfliktit me këtë shtetas në lidhje me kushtet në të cilat ndodhej automjeti dhe dokumentacioni i tij, nuk është bërë e mundur as marrja e dokumentacionit origjinal të automjetit dhe as kthimi i shumës mbrapsht.*

18.7.4 Trupa gjyquese e procesit të rivlerësimit të z. ***. ***, ndër të tjera, i ka kaluar barrën e provës, pasi *subjekti nuk ka provuar me dokumentacion përdorimin/blerjen dhe as shitjen e automjeteve.*

18.7.5 Në prapësimet e tij, z. ***. ***, ka deklaruar [...] *Automjetin *** e kam marrë nga G. H., me të cilin kemi qenë në të njëjtin vit studimor në Shkollën e Magjistraturës dhe ai dhe unë kemi ushtruar përkatësisht detyrën e Prokurorit dhe Gjyqtarit në Gjykatën Shkallës Parë*

²⁰ Referohuni prg. 29.3, të vendimit të Komisionit.

²¹ Referohuni vendimit nr. 624, datë 20.2.2023, të Komisionit.

²² https://kpk.al/wp-content/uploads/2023/03/Vendim-***-***.pdf

Vlorë. Këtë automjet e kam marrë në përdorim për shumën e 2500 eurove, pa doganë të paguar, dhe me premtimin se dokumentacioni i automjetit do të më vihej në dispozicion më vonë, pasi të bëja pagesën. Kam marrë automjetin dhe kam aplikuar për kredi në *** Bank, në vitin 2009 dhe po atë ditë që është disbursuar kredia, kam derdhur shumën e konvertuar në bankë, në emër të G. H. Ja kam kërkuar disa herë dokumentacionin e automjetit dhe targat, por, pasi nxirrte justifikime, kam ndërprerë çdo komunikim, pasi nuk dha asnjë zgjidhje për këtë problem. Në tetor të vitit 2014, këtë automjet e kam shitur për skrap, në pikën e grumbullimit të shtetasit ***. ***. dhe këtë dokument e kam dorëzuar në ILDKPI në vitin 2017 dhe nuk kam dokument tjetër.

18.8 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, gjen me vend të theksojë se vlerësimi i saktësisë dhe i plotësisë së deklaratimit për subjektet e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi, është një ndër dy elementet e vlerësimit të kriterit të pasurisë. Në rastin konkret, për rrethanat sa më sipër rezultuar, duket se subjekti i rivlerësimit Gentian Hamiti, ka bërë deklaratime të pasakta dhe të pavërteta mbi burimin/destinacionin dhe marrjen e shumës prej 2.500 euro, nga z. ***.***., të cilat në procesin e rivlerësimit të z. Hamiti, mbeten deklarative dhe kontradiktore, në raport me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, z. ***. ***., të provuara me deklaratimet periodike të kohës, të cilat, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm dhe jurisprudencën e Kolegjit, përbëjnë provë në këtë proces.

18.9 Mosdeklarimi i kësaj marrëdhënieje dhe përpjekja për ta shfaqur si huadhënie atë, në vlerësimin e Komisionerit Publik konsiderohet si përpjekje e subjektit për të paraqitur ndryshe këtë situatë, për pasojë klasifikimin e saj, në kuptim të nenit D, pika 5 e aneksit të Kushtetutës dhe tregojnë për një sjellje të subjektit të rivlerësimit, e cila është e papranueshme për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe duhet vlerësuar në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në raport me parashikimet e nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

B. Për vlerësimin e kontrollit të figurës

19. Kontrolli i figurës, ndër të tjera, bazohet në deklaratën që plotësohet dhe dorëzohet nga vetë subjekti dhe prova të tjera, përfshirë vendimet e gjykatave shqiptare dhe të huaja²³. Bazuar në nenin 39/2 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK ka përcjellë raportin me nr. *** prot., datë **.10.2017, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Gentian *** Hamiti, me anë të cilit ka referuar: [...] *përshtatshmerinë për vazhdimin e detyrës*[...].

19.1 Referuar të dhënave të përcjella nga vëzhguesi ndërkombëtar²⁴, Komisioni, në dokumentacionin e administruar, ka konstatuar:

(1) *Një lidhje familjare ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit ***. ***. ***., djali i xhaxhait të subjektit të rivlerësimit, shpallur fajtor me vendimin e formës së prerë nr. **/1996, datë *.10.1996, të Gjykatës Penale të Diktimit Janinë, dënuar me 18 vjet e 6 muaj burgim, për veprat penale, të cilat i korrespondojnë dispozitave penale të kohës (neneve*

²³ Paragrafi i dytë i nenit DH të aneksit të Kushtetutës.

²⁴ Shkresa me nr. *** prot., datë **.5.2023, të ONM-së, në dosjen e Komisionit.

283/1 dhe 297 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë), privim të të drejtave politike për 3 vjet dhe dëbim të përjetshëm nga shteti grek.

(2) Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Delvinë, me vendimin nr. **, datë *.5.1998, ka njohur pjesërisht vendimin penal të huaj me nr. **/1996, datë *.10.1996, duke vendosur dënimin me 13 vjet burgim²⁵, duke filluar nga data *.9.1995, vendim i cili ka marrë formë të prerë.

(3) Katër nga pesë veprat për të cilat përcaktohet përgjegjësia penale e z. ***, ***, kanë të bëjnë me mbajtjen, shitjen, transportimin dhe importimin e narkotikëve.

(4) Mbajtja, shitja, transportimi dhe importimi i narkotikëve janë vepra penale në Shqipëri në zbatim të neneve 283 dhe 283/1 të Kodit Penal, janë të përfshira në listën e veprave penale të pikës 1, neni 3 i ligjit nr. 10192/2009, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, si dhe referohen nga pika 15, e nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, për të përcaktuar kategorinë e “personave të përfshirë në krimin e organizuar”. Vepra penale “Importimi i narkotikëve” nuk ishte parashikuar në Kodin Penal Shqiptar të asaj kohe. Kjo veprë penale është shtuar më vonë me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001.

(5) Për veprat të cilat është shpallur fajtor, shtetasi ***, ***, sipas ligjit shqiptar, konsiderohet si person i përfshirë në krimin e organizuar, pasi kualifikohet sipas përcaktimeve ligjore të neneve 283 dhe 283/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, prandaj kontaktet me të janë relevante për qëllimin e kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimit të përgjithshëm për këtë procedurë rivlerësimi.

19.2 Komisioni, me qëllim verifikimin e gjetjes dhe indicieve të përcjella nga vëzhguesi ndërkombëtar, ka kërkuar informacion nga shoqëritë telefonike për të provuar kontaktet e subjektit të rivlerësimit apo bashkëshortes së tij me shtetasin ***, ***, informacion nga i cili ka rezultuar se²⁶:

19.3 Nga informacioni i përcjellë nga shoqëria “*** Albania” sh.a.,²⁷ Komisioni ka konstatuar se, në periudhën korrik – shtator 2021, ka pasur disa komunikime telefonike mes z. Gentian Hamiti dhe një numër kontakti të shoqërisë “***” sh.p.k.

19.4 Nga verifikimi i Komisionit në regjistrin tregtar të QKB-së, ka rezultuar se ekzistojnë të regjistruara dy subjekte tregtare të emëtuara “***”, me formë ligjore sh.p.k.: (i) me NUIS ***, me status “aktiv”, regjistruar në datën *.1.2003, me administrator shtetasin *** ** dhe ortakë me nga 50% të kuotave shtetasit *** ** dhe *** **²⁸, që prej krijimit të saj dhe (ii) me NUIS ***, regjistruar me vendim gjykate në datën *.7.2004, me status “pezulluar”, e cila ka pasur si ortak të saj shtetasit *** **, *** ** dhe *** **.

²⁵ Vuajtur nga shtetasi ***, ***, në Shqipëri.

²⁶ Shoqëria “*** ***” sh.a. ka informuar Komisionin se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk janë të regjistruar në rrjetin mobile të kësaj shoqërie, ndërsa në emër të shtetasit ***, ***, janë të regjistruar tre numra celularë, për të cilët, pas analizimit të thirrjeve hyrëse ose dalëse me numrat e regjistruar të shtetasve *** ** dhe *** ** pranë kompanisë “***”, nuk kanë rezultuar të dhëna.

²⁷ Shihni shkresën nr. ***/* prot., datë *.7.2023, të shoqërisë *** Albania në dosjen e hetimit.

²⁸ Shtetasi ***, ***, duket se është i njëjti shtetas, me pronarin e apartamentit, ku subjekti i rivlerësimit deklaroi se jeton me qira.

19.5 Në këto rrethana, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë më shumë lidhur me këto telefonata dhe qëllimin e tyre, si dhe të shpjegojë në gjykimin e tij bazuar edhe në provat dhe faktet e administruara gjatë hetimit administrativ mbi marrëdhënien e tij me shtetasin *** ***, në kuptim të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, e nenit DH të aneksit të Kushtetutës.

19.6 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: *[...] Nga emrat që janë përmendur më sipër, komunikime telefonike për periudhën korrik – shtator 2021, me sa më kujtohet, kam pasur me djalin e xhaxhait *** ***,... Qëllimi i telefonatave ka qenë për shkaqe shëndetësore ... Së pari, deklaroj se unë në këtë moment vihem në dijeni të faktit që në ngarkim të shtetasit shtetasi ***. ***, ka pasur një dënim penal dhe me të vërtetë jam i shokuar ... Sqaroj se nuk kemi pasur kontakte me njëri - tjetrin, përveç kontakteve sporadike/rastësore si ato të datës *.2.2008, në të cilën është lidhur Kontrata e Shitjes nr. ** rep., nr. ** kol., datë *.2.2008 dhe datë *.12.2009, që është lidhur Deklarata Noteriale nr. *** rep., datë *.12.2009 [...].*

19.7 Komisioni, pas analizimit të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: *“... subjekti ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, të jetë i përfshirë apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të nenit DH të aneksit të Kushtetutës e neneve 34-39 të Kreut V të ligjit nr. 84/2016. Lidhja e tij me shtetasin ***. ***, është një lidhje familjare/gjaku e afërt me subjektin e rivlerësimit, të cilin ai nuk ka zgjedhur të ketë kontakt e, për më tepër, nuk rezultoi të ketë marrëdhënie miqësore të vijueshme, por përkundrazi (edhe ato për shkak të marrëdhënies së posaçme janë të vitit 2009). Ajo që zë peshë në këtë vlerësim është marrëdhënia nëpërmjet shkëmbimit të favoreve apo përfshirja në veprimtari kriminale drejtpërdrejt apo tërthorazi, takime të vazhdueshme me të, apo persona të tjerë të përfshirë në grupe kriminale, rrethana të cilat në fakt nuk rezultuan të kenë ndodhur, përkundrazi, nga subjekti rezultoi se ai ka shmangur në vazhdimësi këtë kontakt/marrëdhënie e se edhe vetë stili i jetës dhe puna e ka distancuar atë tërësisht nga këto situata familjare, të gjendura për shkaqe objektive e natyrale”.*

19.8 Komisioni, në vlerësim tërësor të çështjes, ndër të tjera, ka arritur në përfundim se: *[...] tërësia e sjelljeve të subjektit të rivlerësimit të rezultuara nga hetimi administrativ, të vlerësuara në raport të drejtë e proporcional me kërkesat dhe qëllimin e ligjit për rivlerësimin kalimtar, nuk përbëjnë shkak për aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” [...].*

19.9 Komisioneri Publik, në raport me rrethanat e konstatuara, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi nga aktet e administruara nuk duken bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me mospasjen dijeni të dënimit të shtetasit *** ***.

19.9.1 Ashtu sikurse rezulton nga aktet e administruara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Delvinë, me vendimin nr. **, datë *.5.1998, ka njohur pjesërisht vendimin penal të huaj, me nr. **/1996, datë *.10.1996, duke vendosur dënimin me 13 vjet burgim²⁹, duke filluar nga data *.9.1995, vendim i cili ka marrë formë të prerë. Sa më sipër, nga aktet rezulton se

²⁹ Vuajtur nga shtetasi ***. ***, në Shqipëri.

ky shtetas, në një periudhë në të cilën duket se duhej të ishte duke vuajtur pjesën e mbetur të dënimit në Shqipëri, paraqitet si blerës i truallit prej 300 m² dhe si investitor në kontratën e sipërmarrjes të datës **.5.2004, në një vlerë prej 11.934.706³⁰ lekë.

19.9.2 Lidhur me numrin e telefonit me të cilin ka kontaktuar subjekti i rivlerësimit, Komisioneri Publik, referuar vendimit të Komisionit dhe akteve të përcjella, vlerëson se duket e paqartë se kujt shtetasi i përket, për sa kohë që është një numër i regjistruar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., ku nga aktet duket se ka dy shoqëri të tilla, ortak i njërës prej të cilave është dhe shtetasi *** **.

19.9.3 Ashtu sikurse u referua më lart, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, *pjesë e konstatimeve i përkasin periudhës kur subjekti nuk ka ushtruar asnjë funksion publik apo edhe pak më vonë kur ai ushtronte detyrën e OPGJ-së, marrëdhëniet juridiko-civile dhe konfliktet gjyqësore lidhur me pasurinë truall 300 m², me të cilën është i lidhur dhe shtetasi *** ** në marrëdhënie të ngushtë interesi, datojnë dhe në periudhën kohore kur subjekti ka qenë subjekti rivlerësimi, konkretisht në vitin 2008 dhe vitin 2009.*

19.9.4 Për sa më sipër, Komisioneri Publik çmon se rrethanat e dala nga aktet në dosjen e Komisionit, nuk mbështesin thëniet e subjektit të rivlerësimit *me të qënurit i shokuar nga dënimi, apo se marrëdhënia e tij me shtetasin ***. **.* ka qenë në nivel *takimesh rastësore/sporadike*, pasi nga aktet rezulton një marrëdhënie e ngushtë interesi dhe mirëbesimi, më së paku, deri në momentin kur pasuria prej 300 m², është regjistruar në emër të vëllait dhe shtetasit ***. **.

19.9.5 Në përfundim, Komisioneri Publik vlerëson se të gjitha këto rrethana, së bashku me gjetjet e tjera të trajtuara, duhen të vlerësohen nga Kolegji, në zbatim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, mbi etikën dhe integritetin e magjistratit, dhe referojnë aplikimin e nenit 61, pika 5 të ligjit nr. 84/2016.

20. Mbi vlerësimin e kriterit profesional

20.1 Vëzhguesi ndërkombëtar, në *Gjetjen* nr. ** prot., datë ** janar 2024, ndër të tjera, lidhur me vlerësimin e kriterit profesional, ka vënë në dijeni Komisionin se nga burime të hapura: është konstatuar se, në vitin 2019, vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit Gentian Hamiti është bërë objekt i debatit publik për shkak të marrjes së vendimit për heqjen e masës së pezullimit të aktivitetit të vendosur nga organet tatimore për “Kompleksin ***”, pasi gjatë kontrollit administrativ të kryer në kuadër të aksionit kundër informalitetit nga organi tatimorë u konstatua se nuk kishte lëshuar kuponë tatimorë.

20.2 Bazuar në sa më sipër, në *Gjetjen* e vëzhguesit referohet se: *Komisioni duhet të bëjë një përpjekje për të sqaruar problematikën që rrjedh nga ky informacion nga burime të hapura. Komisioni mund të kërkojë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit dhe të verifikojë nëse vendimi është ankimuar dhe nëse ka ndonjë vazhdimësi të tij.*

³⁰ Referuar vlerës së investimit, të arritur në konkluzionin e Komisionit në prg. 30.4 të vendimit.

20.3 Nga dokumentacioni i përcjellë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë³¹, lidhur me informacionin nga burimet e hapura, ka rezultuar se pranë kësaj Gjykate, është shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit dhe çështja gjyqësore me palë ndërgjyqëse shoqërinë “***” sh.p.k., konkretisht³²:

- Çështja nr. ***-***-**-2019, regjistruar në datë **.08.2019, me objekt “Marrjen e masës së sigurimit të padisë”, me palë kërkuese shoqërinë “***” sh.p.k. dhe personi i tretë “Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë”, shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit gjyqtar Gentian Hamiti, i cili me vendim nr. ska, datë **.08.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë dhe pezullimin e veprimit administrativ.

20.4 Lidhur me këtë vendim, nga aktet e administruara rezulton se:

20.4.1 Shoqëria “***”, ka ngritur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, ndër të tjera, me objekt: *marrjen e masës së sigurimit të padisë*, duke urdhëruar Gjykata pezullimin e veprimeve administrative, për bllokimin e aktivitetit.

20.4.2 Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. **, datë **.8.2019, ndër të tjera, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, pezullimin e zbatimit të veprimit administrativ, për bllokimin e aktivitetit tregtar dhe caktimin e afatit 10-ditor për ngritjen e padisë.

20.4.3 Ndaj vendimit gjyqësor nr. **, datë *.8.2019, të marrë nga subjekti i rivlerësimit, personi i tretë, “Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë”, ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

20.4.4 Gjykata administrative e Apelit, me vendim nr. ** (**-2023-***), datë **.2.2023, ndër të tjera, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, me arsyetimin se: [...] *Gjykata Administrative e Apelit çmon se vendimi nr. ska, datë **.08.2019 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në kohën e dhënies së tij është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material, si dhe rezulton i bazuar në prova dhe ai do të duhej të lihej në fuqi sipas nenit 50/b të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.*

*Nga verifikimi i kryer në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, rezulton se shoqëria “***” sh.p.k. ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurve Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë dhe Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Ministrisë së Financave me objekt: Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore nr. ***/*, datë **.09.2019 të Drejtorisë së Apelimit Tatimore, akt me të cilin lidhet kërkesa për marrjen e masës së sigurimit, vendimi për të cilën është objekt shqyrtimi në rastin konkret. Nga verifikimi ka rezultuar se ajo Gjykatë, me vendimin nr. **-2019- ***, datë **.12.2019, ka vendosur rrëzimin e padisë, heqjen e masës së sigurimit të padisë të marrë nga gjykata me vendim të ndërmjetëm të datës **.08.2019, si dhe në atë vendim është përcaktuar se nuk mund të ushtrohet ankim dhe se ai është vendim i formës së prerë.*

³¹ Referohuni shkresës me nr. ***/* prot., datë **.1.2024, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

³² Nga përgjigjja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë rezulton se është shqyrtuar dhe Çështja nr. ***-***-**-2017, regjistruar në datën **.6.2017, me objekt anulim të aktit administrativ, me palë paditëse shoqërinë “***” sh.p.k. dhe të paditur “Drejtorinë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj”, për të cilën subjekti i rivlerësimit, me vendim nr. **, datë **.9.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë të shoqërisë “***” sh.p.k.

Në këto kushte, gjykimi në themel i padisë nga sa rezulton më lart, është përfunduar me vendim të formës së prerë e për rrjedhje edhe gjykimi ose shqyrtimi i ankimit të veçantë të kërkuarit, “Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë”, duhet të pushohet, pasi ka mbetur efektivisht pa objekt, ashtu si edhe kërkesa për marrjen e masës së sigurimit të padisë[...].³³

20.4.5 Sa më sipër, Komisioni nuk ka konstatuar të dhëna për hetime të mëtejshme, ndaj indicieve të marra nga burime të hapura, si dhe nuk vëren problematika lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

20.4.6 Komisioneri Publik vëren se vendimi nr. **, datë **.8.2019, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, marrë nga subjekti i i rivlerësimit, ndër të tjera, i referohet vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, nr.10., datë 24.3.2004, mbi faktin se *marrja e masave të përkohshme të sigurimit të padisë synon “ta mbajë gjendjen ashtu siç është”, apo “të ngrirë”, deri në zgjidhjen përfundimtare të konfliktit, e cila, për vetë natyrën e çështjes, duhet të realizohet nëpërmjet një procedure të shpejtë dhe relativisht të thjeshtë, duke u kujdesur, gjithsesi, që të respektohet një standard i pranueshëm i një procesi të rregullt ligjor.*

20.4.7 Ndërkohë, po në vendimin unifikues i Gjykatës së Lartë, nr.10., datë 24.3.2004, gjithashtu parashikohet se: *[...] masa e sigurimit nuk mund të merret për t’u rivendosur gjendja e mëparshme e marrëdhënies kontraktore midis palëve, ashtu si ka ekzistuar para lindjes së mosmarrëveshjes. ... Në asnjë rast nuk mund të vendoset me anë të një mase të përkohshme të sigurimit të padisë urdhërimi për të kryer i padituri atë që kërkon paditësi nëpërmjet padisë dhe që prapësohet nga i padituri.*

Në praktikën e Gjykatave të Shkallës së Parë dhe të Apeleve vërehet shpesh që ato konsiderojnë si masë siguri të padisë edhe pezullimin e zbatimit të një akti administrativ të kundërshtuar në gjykatë, duke u referuar, krahas nenit 329 të K. Pr. Civile, edhe nenit 202 e 206/b të këtij Kodi.

Megjithatë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë të mendimit se kërkesa për kundërshtimin në gjykatë të një akti administrativ nuk ka tiparet e një padie civile të mirëfilltë, prandaj edhe pezullimi i zbatimit të aktit administrativ nga ana e gjykatës, kur e lejon ligji, nuk duhet të konsiderohet si një masë e përkohshme për sigurimin e padisë në kuptim të nenit 206, pika “b”, të K. Pr. Civile... Konsiderimi në këto raste i masës së pezullimit të zbatimit të aktit administrativ si masë e përkohshme e sigurimit të padisë e shoqëruar me zvarritje të gjykimit të çështjes, rrezikon të çojë për palën e paditur në shkaktimin e dëmeve të mëdha e të pariparueshme, në eventualitet të rrëzimit të padisë [...].

20.4.8 Sa më sipër, duket se vendimi i subjektit të rivlerësimit, mbi caktimin e masës së sigurisë duke urdhëruar gjykata pezullimin e zbatimit të veprimit administrativ për bllokimin e aktivitetit tregtar të shoqërisë “***” sh.p.k., merr tiparet e një padie civile të mirëfilltë, duke urdhëruar të paditurin të kryejë atë që kërkon paditësi të zgjidhet.

³³ Referohuni më gjerësisht vendimit nr. ***, datë **.2.2023, nga verifikimi i kryer nëpërmjet sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore i Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, pjesë e dosjes së hetimit.

20.4.9 Komisioneri Publik vlerëson se dhe rasti konkret duhet vlerësuar së bashku me gjetjet e tjera në vlerësim tërësor të procedurave, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

21. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Hamiti, në vlerësim tërësor të procedurave, bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik vlerëson se gjetjet e konstatuara janë në kontradiktë me sjelljen që pritet nga një gjyqtar dhe, si pasojë, kanë cenuar besimin e publikut në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

IV. Kërkimi i ankimit

22. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016;

23. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

24. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

25. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 4, pika 2, nenit 61, pika 3, 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

26. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 743, datë 19.3.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Hamiti.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA